



*Akti i Themelimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar*

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
" SKELA AHI" shpk.**

**Nikoll AHI** atesia Fran lindur me 19.06.1986 ne Shkodër dhe banues ne Shkodër , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikur nga karta e identitetit nr.035230633 dhe nr. personal I60619101D

ne cilesine e Ortakut Themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SKELA AHI " shpk.

Personat e mesiperm jane madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ata me vullnetin e tyre te lire e te plote, nepermjet ketij akti themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe kushteve te meposhtme.

**Neni 1**

**Emertimi**

Emeri i shoqerise eshte " SKELA AHI " shpk", me poshte e quajtur "Shoqeria".

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetet me objektin e mëposhtëm:

Dhenie me qira, shitje, prodhim, importim, eksportim, montim, cmontim skelash dhe aksesore skelerie, suvatime, karpentier armaturash, veshje pllake, hekurthyes, lysterje, riparime te ndryshme, instalime, punime elektrike dhe hidraulike. Krijim podiumesh dhe skenash per aktivitete dhe evente te ndryshme .Punime karpenterie druri e metalike .Instalim i materialeve prej druri ,plastike ,dhe xhami .Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme .Punime bojatisje ,hidroizolim ,termoizolim ,akustike ,kunder zjarrit .Tregetim te materialeve te ndryshme te ndertimit si dhe kryerjen e cdo veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe pjesmarrjen ne cdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar

**Neni 3**

**Selia**

1. Shoqëria e ka selinë në adresën: "Ndertesa NR. 1 Rruga" Frang", Lagjia 3 Heronjtë, Shkodër.

Shoqëria mund të hapë edhe zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve të marre me shumicë të thjeshtë votash.

#### Neni 4

##### Kohezgjatja

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka për objekt për një afat të pacaktuar kohe.

#### Neni 5

##### Kapitali Themeltar

5.1. Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 100.000 (Njëqinde mijë) Leke. Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin si vijon:

1. Ortaku Themelues **Nikoll Ahi** - zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 Leke (te reja) që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e percaktuara në pikat 5.3 dhe 5.4 më poshtë.

5.3 Në rast se njëri nga ortakët kërkon të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat që ai zoteron në shoqëri, ai është i detyruar që t'ia ofrojë paraprakisht këto kuota ortakut tjetër të shoqërisë, ose vetë shoqërisë me të njëjtin çmim që ai ka vendosur t'ia shesë ato. Kjo ofertë do të quhet e marre nga ortakët tjetër dhe/ose nga shoqëria, në momentin e depozitimit të saj në selinë e shoqërisë.

5.4 Në rast se ortakët tjetër të shoqërisë, ose shoqëria, brenda 1 muaji nga data e depozitimit të ofertes nuk përgjigjen për këtë ofertë, ose refuzojnë ofertën, ortakët ofertues kanë të drejtë t'ia shesë kuotat e tij palëve të treta. Kalimi i kuotave palëve të treta do të bëhet vetëm kur Asambleja e Përgjishme e



Ortakeve të Shoqërisë e miraton këtë transferim me vendim unanim.

5.5 Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## **Neni 6**

### **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga Administratori i Vetem. Administratori do të mbajë mandatin e tij për një periudhë 5 ( pesë) vjecare me të drejtë të pakufizuar të rinovimit të mandatit. Administratori emërohet me shumicë të thjeshtë votash. Ripërtëritja e mandatit do të bëhet me një vendim të ri të Asamblesë së Përgjithshme, në përfundim të mandatit të parë.

Si administrator i parë i shoqërisë emërohet:

**Nikoll AHI** atesia Fran lindur me 19.06.1986 në Shkodër dhe banues në Shkodër, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, identifikur nga karta e identitetit nr.035230633 dhe nr. personal I60619101D

Kompetencat dhe kufizimet në ushtrimin e detyrës së administratorit parashikohen në statutin e shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësia Personale**

Prona personale e ortakëve, administratorëve, punonjësve dhe/ose agjenteve të Shoqërisë, është e përjashtuar nga çfarëdo lloj detyrimi që rëndon mbi Shoqërinë.

## **Neni 9**

### **Dispozita Operative**

Klauzolat për zhvillimin, rregullimin dhe drejtimin e aktivitetit ekonomik dhe punëve të brendshme



te Shoqerise do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise, i cili mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim të kualifikuar të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 10**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 dhjetor 2021.

Nenshkruar nga ne ortaku themelues 19.03.2021

**Nikoll AHI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Nikoll Ahi', followed by a large, stylized flourish or scribble.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER AIDA A. HOXHA



V2021051010100514522

DATE 20/03/2021  
NR REP 1295

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 20.03.2021, para meje Notere AIDA A. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, MINE PEZA, NR.83/1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:** **Nikoll Ahi**, atësia Fran, amësia Gjyste, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Tre Heronjt; Nd. 141; H. 00; Ap. 000; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 19/06/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035230633 dhe nr. personal I60619101D , .

Personi i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, dokumentin: **Akti i Themelimit i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SKELA AHI" SHPK**, bashkëlidhur ketij vertetimi noterial deklaroi se e ka hartuar dhe nënshkruar personalisht me vullnet të lirë dhe të plotë.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të personit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

AIDA A. HOXHA